

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar
"OKTAGON" sh.p.k.

Sot më 09/10/2025, u themelua shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, nga: Z.Nazmi Kurti , shtetas shqiptar, lindur më 13.03.1987, në Bastar, me banim në Tiranë, mbajtës i lertërnjoftimit me numër personal : I70313132R ,Z.Isan Krasniqi , shtetas shqiptar , lindur më 04.02.1991 në Orcikel, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal :J10204110D , Shoqëria "Orbit " shpk , e regjistruar në QKB me nr NIPT-I M12220005C, me përfaqësues ligjor Z.Edmon Licaj , shtetas shqiptar, lindur më 01.06.1989 , në Maqellarë, banues në Tiranë , mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: I90601002F, si dhe Z. Brenton Kotorri , shtetas shqiptar, lindur më 10.05.1991 , në Elbasan, me banim në Tiranë , mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J10510099D, (në vijim referuar si "Ortakët").

Shoqëria dhe marrëdhënia e saj me Ortakët rregullohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi dhe dispozitat e këtij statuti (në vijim "Statuti"), i cili përbën edhe aktin e themelimit të shoqërisë.

KREU I

EMRI, FORMA, SEALIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, DEGËT DHE ZYRAT E PËRFAQËSIMIT, PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE

Neni 1 – Themelimi dhe emri

1.1. Sot, më datë 09/10/2025, u themelua shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "OKTAGON" sh.p.k. Shoqëria fiton personalitet juridik pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

1.2. Shoqëria mund të përdorë edhe emra tregtarë ose shkurtime të tjera, të miratuara nga Administratori.

1.3. Ndryshimi i emrit bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me ligjin.



Neni 2 – Forma ligjore

Shoqëria "OKTAGON" është shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), e themeluar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Neni 3 – Selia

3.1. Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga "Karl Gega", ndërtesa nr.11, zyra 1, njësia administrative nr.9, kodi postar 1016. Tiranë.

3.2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe çdo ndryshim regjistrohet në QKB.

Neni 4 – Objekti i veprimtarisë

4.1. Shoqëria do të ushtroje veprimtari në fushën e shërbimit : Shërbime të Mardhenieve me Publikun dhe Marketingut

4.2. Shoqëria mund të ushtrojë edhe veprimtari të tjera tregtare, industriale, financiare, të pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, në përputhje me ligjin, që lidhen ose janë të dobishme për realizimin e qëllimit të saj.

4.3. Shoqëria mund të zgjerojë objektin e veprimtarisë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, duke respektuar procedurat ligjore përkatëse.

Neni 5 – Kohëzgjatja

Shoqëria themelohet për një kohë të pacaktuar. Kohëzgjatja mund të kufizohet ose ndryshohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 6 – Degët dhe zyrat e përfaqësimit

Shoqëria mund të hapë degë, filiale ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 7 – Përgjegjësia e ortakëve

7.1. Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e Shoqërisë, përtej pjesës së pashlyer të kuotave të tyre.

7.2. Ortakët ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre me mirëbesim dhe në përputhje me ligjin dhe këtë statut.



KREU II

KAPITALI, KUOTAT DHE KALIMI I TYRE

Neni 8 – Kapitali i regjistruar

8.1. Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mije) lekë, i ndarë në kuota të shlyera plotësisht në para.

8.2. Pjesëmarrja e ortakëve në kapital është si më poshtë:

- Nazmi Kurti, 20% të kapitalit;
- Isan Krasniqi, 20% të kapitalit;
- Orbit shpk , 30% të kapitalit;
- Brenton Kotorri, 30% të kapitalit.

Neni 9 – Rritja e kapitalit

9.1. Kapitali i Shoqërisë mund të rritet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me ligjin.

9.2. Rritja e kapitalit mund të bëhet në para ose në natyrë. Kontributet në natyrë duhet të vlerësohen sipas ligjit.

9.3. Ortakët kanë të drejtën e përparësisë për të marrë pjesë në rritjen e kapitalit, në përpjesëtim me kuotat e tyre.

Neni 10 – Ulja e kapitalit

10.1. Kapitali i Shoqërisë mund të ulet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me ligjin.

10.2. Ulja e kapitalit regjistrohet në QKB dhe u bëhet e ditur kreditorëve, sipas afateve ligjore.

Neni 11 – Kuotat

11.1. Kuota është pjesëmarrja e një ortaku në kapitalin e Shoqërisë.

11.2. Kuotat janë të pandashme dhe nuk mund të përfaqësohen me tituj me vlerë.

11.3. Çdo ortaku i lëshohet dëshmia e kuotës, sipas ligjit.

Neni 12 – Transferimi i kuotave

12.1. Ortaku nuk mund të shesë, dhurojë ose transferojë kuotën e tij tek persona të tretë për një periudhë **1 (një) viti** nga data e fitimit të cilësisë së ortaku.

12.2. Ky kufizim nuk zbatohet nëse transferimi bëhet ndërmjet ortakëve ekzistues të Shoqërisë.

12.3. Pas përfundimit të afatit të sipërpërmendur, ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij duhet t'ua ofrojë fillimisht ortakëve të tjerë, duke respektuar të drejtën e tyre të parablerjes.

12.4. Ortakët e tjerë duhet të përgjigjen me shkrim brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit. Nëse nuk e ushtrojnë të drejtën e parablerjes brenda këtij afati, ortaku mund të transferojë kuotën tek persona të tretë.

12.5. Çdo transferim bëhet me akt të noterizuar dhe regjistrohet në QKB.

12.6. Çdo barrë ose kufizim mbi kuota ka efekt vetëm pas regjistrimit në QKB.

12.7. Në rast mosmarrëveshjeje për çmimin e kuotave, palët kanë të drejtë t'i drejtohen ndërmjetesimit, gjykatës, ose arbitrazhit, sipas marrëveshjes.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13 – Organet drejtuese

13.1. Organet e Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- b) Administratori ose organi administrativ.

13.2. Kompetencat e organeve, thirrja dhe zhvillimi i mbledhjeve, mënyra e votimit dhe afatet, rregullohen nga ky statut dhe nga legjislacioni në fuqi.

Neni 14 – Asambleja e Përgjithshme

14.1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

14.2. Asambleja përbëhet nga të gjithë ortakët. Secili ortaku ka të drejtë vote në përpjesëtim me pjesën që zotëron në kapitalin e Shoqërisë.

14.3. Asambleja mbledhet të paktën një herë në vit për të miratuar pasqyrat financiare, shpërndarjen e fitimeve dhe për të marrë vendime të tjera të rëndësishme.

14.4. Asambleja thirret nga administratori ose me kërkesën me shkrim të ortakëve që zotërojnë të paktën 1/10 e kapitalit.

14.5. Njoftimi për mbledhjen dërgohet të paktën 15 ditë përpara datës së



caktuar dhe duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, orën dhe vendin e zhvillimit. Njoftimi dërgohet me postë, email ose mjete të tjera të komunikimit elektronik, në adresat e deklaruara zyrtarisht në QKB.

14.6. Asambleja është e vlefshme kur marrin pjesë ortakët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit.

14.7. Vendimet merren me shumicën e kapitalit të përfaqësuar, përveç rasteve kur ligji ose ky statut kërkon shumicë të cilësuar.

14.8. Vendimet për ndryshimin e statutit, rritjen ose uljen e kapitalit, shpërbërjen e Shoqërisë, emërimin ose shkarkimin e administratorit, kërkojnë votën e të paktën 3/4 të kapitalit të Shoqërisë.

14.9. Procesverbali i mbledhjes mbahet nga një sekretar dhe nënshkruhet nga kryetari i mbledhjes dhe nga ortakët pjesëmarrës.

Neni 15 – Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca kryesore:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore;
- b) vendosja për shpërndarjen e fitimeve ose mbulimin e humbjeve;
- c) rritja ose ulja e kapitalit;
- ç) ndryshimi i statutit;
- d) emërimi dhe shkarkimi i administratorit;
- dh) miratimi i politikave të përgjithshme të Shoqërisë;
- e) vendime për bashkime, ndarje, transformime ose shpërbërje të Shoqërisë;
- ë) çdo kompetencë tjetër e parashikuar nga ligji ose ky statut.

Neni 16 – Administratori

16.1. Shoqëria administrohet dhe përfaqësohet nga një Administrator i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme.

16.2. Administratori emërohet për një mandat 1-vjeçar dhe mund të rizgjidhet.

16.3. Administratori përfaqëson Shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet me të tretët, përfshirë organet shtetërore, gjykatat, institucionet bankare, si dhe ka kompetencën për nënshkrimin e kontratave, marrëveshjeve dhe dokumenteve të tjera.

16.4. Administratori është i detyruar të veprojë me kujdes dhe besnikëri në interes të Shoqërisë dhe të ortakëve.

16.5. Kompetencat e administratorit mund të kufizohen nga Asambleja e Përgjithshme, por kufizimet nuk kanë efekt ndaj të tretëve të mirëbesuar.

16.6. Administratori raporton para Asamblesë së Përgjithshme mbi veprimtarinë e Shoqërisë, të paktën një herë në vit.

16.7. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, me shumicën e cilësuar të parashikuar në këtë statut.


16.8. Adminsitratori i pare i shoqerise eshte z. Brenton Kotorri

Te dhena per adminsitratorin Brenton Kotorri :

Lindur me 10.05.1991

Numer personal identifikimi J10510099D

Specimeni i nenshkrimit:



KREU IV


FITIMET, HUMBJET DHE KONTROLLI

Neni 17 – Fitimet

- 17.1. Fitimi i pastër vjetor i Shoqërisë përcaktohet sipas pasqyrave financiare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.
- 17.2. Nga fitimi i pastër zbriten fillimisht rezervat ligjore dhe statutore, sipas parashikimeve ligjore.
- 17.3. Fitimi i mbetur shpërndahet ndërmjet ortakëve në përpjesëtim me kuotat e tyre në kapital, përveçse kur Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe.

Neni 18 – Humbjet

- 18.1. Humbjet financiare mbulohen fillimisht nga rezervat ligjore dhe statutore.
- 18.2. Nëse humbjet tejkalojnë rezervat, ato mbulohen nga fitimet e ardhshme ose nga kapitali, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.3. Ortakët nuk janë të detyruar të mbulojnë humbjet përtej kontributeve të tyre të shlyera.



Neni 19 – Rezervat

19.1. Shoqëria krijon një rezervë ligjore prej jo më pak se 5% të fitimit neto vjetor, deri sa kjo rezervë të arrijë të paktën 10% të kapitalit të regjistruar.

19.2. Shoqëria mund të krijojë edhe rezerva të tjera, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 20 – Dividentët

20.1. Shpërndarja e dividendëve bëhet pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore dhe pas shlyerjes së detyrimeve tatimore.

20.2. Dividentët u shpërndahen ortakëve në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

20.3. Afatet dhe mënyra e shpërndarjes përcaktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

KREU V

KONTROLLI DHE MBULIMI FINANCIAR

Neni 21 – Kontabiliteti

21.1. Shoqëria është e detyruar të mbajë librat kontabël dhe dokumentacionin financiar në përputhje me ligjin shqiptar.

21.2. Administratori kujdeset për mbajtjen e saktë të librave, përgatitjen e bilancit vjetor dhe depozitim të tij pranë organeve kompetente.

Neni 22 – Kontrolli i brendshëm

22.1. Shoqëria mund të caktojë një ekspert kontabël ose auditor të pavarur për kontrollin e pasqyrave financiare, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

22.2. Eksperti ose auditori ka të drejtë të verifikojë të gjitha librat dhe dokumentacionin financiar të Shoqërisë dhe raporton gjetjet e tij para Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 23 – Transparenca

23.1. Çdo ortak ka të drejtë të informohet mbi gjendjen financiare të Shoqërisë dhe të konsultojë librat dhe dokumentacionin zyrtar, duke bërë



kërkesë me shkrim administratorit.

23.2. Administratori është i detyruar të vërë në dispozicion dokumentet brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

23.3. Mosdhënia e informacionit përbën shkelje të rëndë dhe jep të drejtë ortakut të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykatë.

KREU VI

DISPOZITA TË TJERA

Neni 24 – Ndryshimet e statutit

24.1. Ky statut mund të ndryshohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e cilësuar të përcaktuar në këtë statut dhe në ligj.

24.2. Çdo ndryshim regjistrohet pranë QKB-së dhe hyn në fuqi pas regjistrimit.

Neni 25 – Shpërbërja e Shoqërisë

25.1. Shoqëria shpërbëhet në rastet e parashikuara nga ligji dhe ky statut, si dhe me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

25.2. Shpërbërja regjistrohet pranë QKB-së dhe i bëhet e ditur kreditorëve, sipas afateve ligjore.

Neni 26 – Likuidimi

26.1. Pas vendimit për shpërbërje, Shoqëria hyn në proces likuidimi.

26.2. Likuidatorët caktohen nga Asambleja e Përgjithshme ose nga gjykata, sipas ligjit.

26.3. Likuidimi bëhet në përputhje me dispozitat ligjore, duke shlyer fillimisht detyrimet ndaj shtetit, kreditorëve dhe më pas duke shpërndarë pasurinë e mbetur ndërmjet ortakëve, në përpjesëtim me kuotat e tyre.

Neni 27 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

27.1. Çdo mosmarrëveshje që lind nga ky statut ose nga marrëdhëniet ndërmjet ortakëve dhe Shoqërisë do të zgjidhet fillimisht me mirëkuptim mes palëve.

27.2. Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet në këtë mënyrë, ajo i nënshtrohet ndërmjetësimit dhe me pas gjykatës kompetente në



Republikën e Shqipërisë, përveçse kur palët bien dakord me shkrim për arbitrazh.

Neni 28 – Dispozita të tjera

28.1. Për çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë statut, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe legjislacioni tjetër në fuqi.

28.2. Ky statut hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga ortakët themelues dhe pas regjistrimit pranë QKB-së.

KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 29 – Fuqia ligjore

29.1. Ky statut është hartuar dhe nënshkruar nga ortakët themelues në Tiranë, më datë 09/10/2025, në 5 (pesë) kopje origjinale, me fuqi të barabartë ligjore.

29.2. Çdo kopje e statutit u dorëzohet ortakëve, ndërsa një kopje depozitohet pranë QKB-së.

Nënshkrimet e ortakëve themelues


Nazmi Kurti



Isan Krasniqi



ORBIT Sh.p.k , Administrator (Edmond Licaj)



Brenton Kotorri

